

## NJOFTIM

Komuna e Prishtinës, në cilësinë e koordinatorit të projektit “Themelimi i Tregut Mobil të Fermerëve në Prishtinë”, i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe i implementuar në partneritet me OJQ Gratë në Biznes dhe OJQ CEED Kosova, bën të ditur se tashmë ka finalizuar procesin e dizajnit të standave për tregun mobil të fermerëve në Prishtinë dhe ka përmbyllur njëkohësisht procesin e Konkursit për "Projektimin arkitektonik të standave dhe tregut mobil të fermerëve në Prishtinë". Në këtë konkurs të publikuar më datë 20 korrik 2015 dhe të mbyllur më datë 03 gusht 2015 kanë shprehur interes dhe kanë marrë detyrën projektuese 25 aplikues gjithësej (kompani të arkitekturës dhe arkitektë të pavarur).

Pavarësisht kësaj, Komisioni për vlerësimin e Projekteve arkitektonike i përbërë nga 7 anëtarë ka konstatuar se deri në skadim të afatit të caktuar në këtë konkurs, datë 03 gusht 2015 ora 16:00, nuk është dorëzuar asnjë koncept-projekt, nga asnjë kompani, sipas termave të referencës të shpallura në Konkurs.

Pavarësisht faktit se projekti dhe Komuna e Prishtinës kanë dashur që të përfshijnë dhe t'i japin mundësi sa më shumë kompanive të arkitekturës të ofrojnë idetë e tyre kreative për zgjidhjen arkitektonike të standave për tregun mobil të fermerëve në Prishtinë, në mungesë të ofrimit të ideve dhe për arsye të përshpejtimin të dinamikës së projektit Bordi Menaxhues i Projektit ka vendosur që të finalizojë detyrën projektuese të dizajnit arkitektonik të standave për këtë treg duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës.

